

Direktiva (BE) 2022/1999 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 19 tetor 2022, mbi procedurat uniforme për kontrollet në transportin rrugor të mallrave të rrezikshme (kodifikim).

Kjo Tabelë e Përputhshmërisë vlerëson nivelin e përafrimit të Projektligjit “Për transportin e mallrave të rrezikshme” me Direktivën (BE) 2022/1999 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 19 tetor 2022, mbi procedurat uniforme për kontrollet në transportin rrugor të mallrave të rrezikshme (kodifikim), siç është ndryshuar.

Direktiva (BE) 2022/1999 përcakton një kuadër të harmonizuar për kontrollet në rrugë të mallrave të rrezikshme të transportuara me rrugë. Ajo mbulon, në veçanti, fushën e kontrolleve, përkufizimet përkatëse, kontrollet përfaqësuese dhe të rastësishme, përdorimin e një liste standarde kontrolli, marrjen e mostrave, kohëzgjatjen e arsyeshme të kontrolleve, ndalimin e mjeteve dhe masat korrigjuese, kontrollet në mjediset e ndërmarrjeve, ndihmën e ndërsjellë ndërmjet autoriteteve kompetente dhe raportimin pranë Komisionit Evropian.

Projektligji pasqyron kërkesat kryesore të Direktivës që duhet të parashikohen në nivel ligji, nëpërmjet një kreu të posaçëm për kontrollin rrugor të transportit të mallrave të rrezikshme. Ai siguron bazën ligjore për kontrollet në rrugë, kontrollet në mjediset e subjekteve të kontrollit, klasifikimin e shkeljeve sipas kategorive të rrezikut, masat korrigjuese, ndalimin e mjeteve, refuzimin e hyrjes kur një mjet hyn nga një shtet tjetër dhe shkelja cenon sigurinë e transportit, shkëmbimin e informacionit me shtetet e tjera dhe raportimin pranë Komisionit Evropian pas anëtarësimit.

Çështja e mbetur e përafrimit lidhet me zbatimin teknik të Aneksit I, Aneksit II dhe Aneksit III të Direktivës, përkatësisht listën standarde të kontrollit, listën e hollësishme jo shteruese të shkeljeve sipas kategorive të rrezikut dhe formatin standard të raportimit. Këto elemente nuk është e përshtatshme të riprodhohen tërësisht në ligjin parësor dhe pritet të plotësohen nëpërmjet vendimit të Këshillit të Ministrave të miratuar në zbatim të nenit 49, pika 8, të Projektligjit. Aneksat ekzistuese të udhëzimit nr. 3985/4, datë 24.6.2013, duhet të zëvendësohen me aktin e ri zbatues.

Dispozitat institucionale të BE-së, dispozitat e shfuqizimit, afatet historike të raportimit, dispozitat e kodifikimit dhe detyrimet që u drejtohen vetëm Komisionit Evropian, Parlamentit Evropian ose Këshillit nuk kërkojnë transpozim në Projektligj.

Në bazë të këtij vlerësimi, niveli i përgjithshëm i përafrimit vlerësohet si Përafrim i konsiderueshëm, brenda intervalit 80%-100% të përafrimit, në pritje të miratimit të legjislacionit zbatues të kërkuar sipas nenit 49, pika 8, të Projektligjit për përafrim të plotë.

Direktiva (BE) 2022/1999 (Tabela e Përputhshmërisë)

Direktiva (BE) 2022/1999 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 19 tetor 2022, mbi procedurat uniforme për kontrollet në transportin rrugor të mallrave të rrezikshme (kodifikim) Ndryshuar me Vendimin (BE) 2024/1254 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 24 prill 2024; Direktivën e Deleguar (BE) 2025/1801 të Komisionit, të datës 23 qershor 2025. (CELEX L 274, 24.10.2022, f. 1)		Legjislacioni shqiptar i propozuar (titulli i projektaktit) 1.1. Projektligji “Për transportin e mallrave të rrezikshme” 1.2. Udhëzimi nr. 3985/4, datë 24.6.2013, “Mbi procedurat e kontrollit në transportin rrugor të mallrave të rrezikshme” Niveli i përgjithshëm i përafrimit të projektaktit (një nga alternativat e mëposhtme) F – Plotësisht e harmonizuar P – Pjesërisht e harmonizuar N – Pa Harmonizuar n/a – jo relevante për përafrim Shkalla e përputhshmërisë: P (e plotë).				
1	2	3	4	5	6	7
Neni	Teksti	Referenca	Neni	Teksti	Përputhshmëria	Komente
1, paragrafi i parë	Kjo direktivë zbatohet për kontrollet e kryera nga shtetet anëtare mbi transportin rrugor të mallrave të rrezikshme me mjete që qarkullojnë në territorin e tyre ose hyjnë në të nga një vend i tretë.	1.1	49.1	49.1 Ky kre zbatohet për kontrollin e transportit rrugor të mallrave të rrezikshme me mjete që qarkullojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë ose hyjnë në territorin e saj nga një shtet tjetër.	F	Projektligji përcakton se kreu për kontrollin rrugor zbatohet për mjetet që qarkullojnë në Shqipëri ose hyjnë në territorin e saj nga një shtet tjetër.
1, paragrafi i dytë	Ajo nuk zbatohet për transportin e mallrave të rrezikshme me mjete që u përkasin ose janë nën përgjegjësinë e forcave të armatosura.	1.1	49.2; 3.3(a)	Neni 49 Fusha dhe qëllimi i kontrollit rrugor 49.2 Ky kre nuk zbatohet për transportin e mallrave të rrezikshme me mjete që i përkasin ose janë nën përgjegjësinë e Forcave të Armatosura, sipas nenit 3 të këtij ligji.	F	Përjashtimi pasqyrohet si në fushën e përgjithshme të zbatimit të Projektligjit, ashtu edhe në kreun e posaçëm për kontrollin rrugor.

				3.3 Ky ligj nuk zbatohet për transportin e mallrave të rrezikshme: a) me mjete rrugore ose vagonë që u përkasin ose janë nën përgjegjësinë e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, si dhe forcave të armatosura të shteteve të tjera, në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare në fuqi;		
2	Për qëllimet e kësaj direktive, zbatohen përkufizimet e mëposhtme:	1.1	50	Për qëllime të këtij kreu, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:	F	Përkufizimet përkatëse përfshihen në nenin 50 të Projektligjit.
2 (a)	“mjet” nënkupton çdo mjet motorik të destinuar për përdorim në rrugë, të plotë ose jo të plotë, që ka të paktën katër rrota dhe shpejtësi maksimale të projektuar mbi 25 km/orë, së bashku me rimorkiot e tij, me përjashtim të mjeteve që lëvizin mbi shina, traktorëve bujqësorë dhe pyjorë dhe të gjitha makinerive të lëvizshme;	1.1	50.4	50.4 “Mjet rrugor” është çdo mjet motorik i destinuar për përdorim në rrugë, i plotë ose jo i plotë, që ka të paktën katër rrota dhe shpejtësi maksimale të projektuar mbi 25 km/orë, së bashku me rimorkiot e tij, me përjashtim të mjeteve që lëvizin mbi shina, traktorëve bujqësorë dhe pyjorë dhe makinerive të lëvizshme.	F	Përkufizimi është transpozuar në përmbajtje dhe ndjek formulimin e Direktivës.
2 (b)	“mallra të rrezikshme” nënkupton mallrat e rrezikshme siç përcaktohen në nenin 1, shkronja “b”, të Marrëveshjes Evropiane për transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave të rrezikshme (ADR), të lidhur në Gjenevë më 30 shtator 1957, dhe në anekset A dhe B të kësaj marrëveshjeje, siç referohen në seksionin I.1 të Aneksit I të Direktivës 2008/68/KE;	1.1	50.3	50.3 “Mallra të rrezikshme” janë mallrat e rrezikshme sipas kuptimit të dhënë në nenin 1, shkronja “b”, të Marrëveshjes ADR, të lidhur në Gjenevë më 30 shtator 1957, dhe në anekset A dhe B të kësaj marrëveshjeje, siç referohen në këtë ligj.	F	Projektligji i referohet ADR-së dhe mallrave të rrezikshme që mbulohen nga rregullat e transportit rrugor.
2 (c)	“transport” nënkupton çdo operacion transporti rrugor të kryer me një mjet, tërësisht ose pjesërisht në rrugë publike brenda territorit të një shteti anëtar, përfshirë ngarkimin dhe shkarkimin e mallrave që mbulohen nga Direktiva 2008/68/KE, pa cenuar rregullimet e përcaktuara nga legjislacioni i shteteve anëtare lidhur me përgjegjësinë për operacione të tilla;	1.1	50.5	50.5 “Transport rrugor” është çdo operacion transporti rrugor i kryer me mjet rrugor, tërësisht ose pjesërisht në rrugë publike brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, për transportin e mallrave të rrezikshme, përfshirë ngarkimin dhe shkarkimin e mallrave që mbulohen nga ky ligj.	F	Përkufizimi është transpozuar për kontekstin shqiptar. Rregullat për përgjegjësinë vazhdojnë të rregullohen nga legjislacioni i zbatueshëm në fuqi.
2 (d)	“ndërmarrje” nënkupton çdo person fizik ose juridik, pavarësisht nëse synon ose jo fitim, çdo	1.1	50.6	50.6 “Subjekt i kontrollit” është çdo person fizik ose juridik, pavarësisht nëse ushtron veprimtari	F	Projektligji përdor termin “subjekt i kontrollit”, por mbulon përmbajtjen

	bashkim ose grup personash pa personalitet juridik, pavarësisht nëse synon ose jo fitim, dhe çdo organ që i përket një autoriteti publik, pavarësisht nëse ka vetë personalitet juridik ose varet nga një autoritet që ka një personalitet të tillë, që transporton, ngarkon ose shkarkon mallra të rrezikshme ose shkakton transportimin e tyre, si dhe ata që, si pjesë e një operacioni transporti, i ruajnë përkohësisht, i mbledhin, i ambalazhojnë ose i marrin në dorëzim këto mallra dhe ndodhen në territorin e Bashkimit.			fitimprurëse ose jo, çdo bashkim ose grup personash pa personalitet juridik, pavarësisht nëse ushtron veprimtari fitimprurëse ose jo, si dhe çdo organ që i përket një autoriteti publik, pavarësisht nëse ka personalitet juridik ose varet nga një autoritet që ka personalitet juridik, i cili kryen, ngarkon ose shkarkon mallra të rrezikshme, shkakton kryerjen e transportit të tyre, ose që, si pjesë e një operacioni transporti, i ruan përkohësisht, i mbledh, i ambalazhon ose i merr në dorëzim këto mallra dhe ndodhet në territorin e Republikës së Shqipërisë.		e përkufizimit të Direktivës për “ndërmarrjen”.
3.1	Shtetet anëtare sigurojnë që një pjesë përfaqësuese e dërgesave të mallrave të rrezikshme të transportuara me rrugë t’u nënshtrohet kontrolleve të parashikuara në këtë direktivë, me qëllim verifikimin e përputhjes së tyre me legjislacionin për transportin rrugor të mallrave të rrezikshme.	1.1	49.5	49.5 Autoritetet kompetente sigurojnë që një pjesë përfaqësuese e dërgesave të mallrave të rrezikshme të transportuara me rrugë t’u nënshtrohet kontrolleve të parashikuara në këtë kre, me qëllim verifikimin e përputhjes së tyre me legjislacionin për transportin rrugor të mallrave të rrezikshme.	F	Transpozuar drejtpërdrejt.
3.2	Kontrolle të tilla kryhen në territorin e një shteti anëtar në përputhje me nenin 3 të Rregullores (KE) nr. 1100/2008 dhe nenin 1 të Rregullores (KEE) nr. 3912/92.	1.1	49.3	49.3 Kontrollat sipas këtij kreu kryhen në territorin e Republikës së Shqipërisë, në përputhje me këtë ligj, ADR-në, legjislacionin në fuqi për qarkullimin rrugor, legjislacionin doganor dhe kufitar, si dhe rregullat e tjera të zbatueshme për kontrollin e transportit rrugor.	F	Projektligji i lidh kontrollat rrugore me kuadrin kombëtar të zbatueshëm për qarkullimin rrugor, kontrollet doganore dhe kufitare. Rregulloret e BE-së të referuara në Direktivë janë të rëndësishme në kontekstin e BE-së dhe do të jenë të zbatueshme për Shqipërinë pas anëtarësimit, sipas rastit.
4.1	Për kryerjen e kontrolleve të parashikuara në këtë direktivë, shtetet anëtare përdorin listën e kontrollit të përcaktuar në Aneksin I. Një kopje e kësaj liste kontrollit ose një vërtetim që tregon rezultatin e kontrollit, i hartuar nga autoriteti që e ka kryer atë,	1.1 1.2	49.8(a); 51.1– 51.4	49.8 Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrisë përgjegjëse për transportin, përcakton me vendim rregullat e hollësishme teknike për kontrollin rrugor të transportit të mallrave të	F	Projektligji siguron bazën ligjore dhe rregullat kryesore procedurale. Lista standarde e kontrollit dhe dokumenti i rezultatit duhet të

	i jepet drejtuesit të mjetit dhe paraqitet me kërkesë, me qëllim lehtësimin ose shmangien, kur është e mundur, të kontrolleve të mëvonshme. Paragrafi i parë nuk cenon të drejtën e shteteve anëtare për të kryer masa të posaçme për kontrolle të hollësishme.			rrezikshme, të cilat përfshijnë: a) formatin standard të listës së kontrollit të përdorur për kryerjen e kontrolleve sipas nenit 51, pika 1, të këtij ligji, si dhe formatin e dokumentit që vërteton rezultatin e kontrollit sipas nenit 51, pika 2, të këtij ligji; 51.1 Për kryerjen e kontrolleve të parashikuara në këtë kre përdoret lista e kontrollit sipas formatit standard të miratuar në zbatim të nenit 49, pika 8, shkronja “a”, të këtij ligji. 51.2 Një kopje e listës së kontrollit ose e dokumentit që vërteton rezultatin e kontrollit, sipas formatit standard të miratuar në zbatim të nenit 49, pika 8, shkronja “a”, të këtij ligji, i jepet drejtuesit të mjetit rrugor nga autoriteti që ka kryer kontrollin. 51.3 Lista e kontrollit ose dokumenti që vërteton rezultatin e kontrollit paraqitet nga drejtuesi i mjetit rrugor, kur kërkohet nga autoritetet kompetente, me qëllim lehtësimin ose shmangien, kur është e mundur, të kontrolleve të mëvonshme. 51.4 Pikat 1, 2 dhe 3 të këtij neni nuk cenojnë të drejtën e autoriteteve kompetente për të kryer masa ose kontrolle të posaçme më të hollësishme, kur kjo është e nevojshme për verifikimin e sigurisë së transportit.		plotësohen me legjislacionin zbatues në përputhje me Aneksin I, siç është ndryshuar. Aneksi II i udhëzimit nr. 3985/4, datë 24.6.2013, “Mbi procedurat e kontrollit në transportin rrugor të mallrave të rrezikshme”, duhet të shfuqizohet me miratimin e vendimit të ri të Këshillit të Ministrave në zbatim të nenit 49.8.
4.2	Kontrollet kryhen në mënyrë të rastësishme dhe, për aq sa është e mundur, mbulojnë një pjesë të gjerë të rrjetit rrugor.	1.1	49.6	49.6 Kontrollet rrugore kryhen në mënyrë të rastësishme dhe, për aq sa është e mundur, mbulojnë një pjesë të gjerë të rrjetit rrugor.	F	Projektligji pasqyron kërkesën që kontrollet rrugore të kryhen në mënyrë të rastësishme dhe, për aq sa është e mundur, në një pjesë të gjerë të rrjetit rrugor, duke siguruar që

						kontrollat të mos kufizohen në vende fikse ose të parashikueshme.
4.3	Vendet e zgjedhura për kontrollat duhet të mundësojnë që mjetet që kanë kryer shkelje të sillen në përputhje ose, kur autoriteti që kryen kontrollin e çmon të përshtatshme, të ndalohen në vend ose në një vend të caktuar për këtë qëllim nga ai autoritet, pa shkaktuar rrezik për sigurinë.	1.1	51.5	51.5 Vendet e zgjedhura për kryerjen e kontrollit rrugor duhet të mundësojnë sjelljen e mjetit në përputhje me kërkesat e zbatueshme ose, kur autoriteti që kryen kontrollin e vlerëson të përshtatshme, ndalimin e tij në vend ose në një vend tjetër të caktuar për këtë qëllim, pa shkaktuar rrezik për sigurinë.	F	Projektligji transpozon kërkesën për zgjedhjen e vendeve të kontrollit, duke siguruar që mjetet me shkelje të mund të sillen në përputhje ose të ndalohen në një vend të sigurt, pa krijuar rreze shtesë për sigurinë.
4.4	Kur është e përshtatshme dhe me kusht që kjo të mos përbëjë rrezik për sigurinë, mund të merren mostra të mallrave të transportuara për ekzaminim nga laboratorë të njohur nga autoriteti kompetent.	1.1	51.6	51.6 Kur është e përshtatshme dhe me kusht që kjo të mos përbëjë rrezik për sigurinë, mund të merren mostra të mallrave të transportuara për ekzaminim nga laboratorë të njohur nga autoriteti kompetent ose të akredituar sipas legjislacionit në fuqi.	F	Projektligji siguron bazën ligjore për marrjen e mostrave të mallrave të transportuara, kur është e përshtatshme dhe në varësi të kushteve të sigurisë, dhe kërkon ekzaminimin e tyre nga laboratorë të njohur ose të akredituar.
4.5	Kontrollat nuk duhet të tejkalojnë një kohëzgjatje të arsyeshme.	1.1	51.7	51.7 Kontrolli rrugor nuk zgjat më shumë se koha e arsyeshme e nevojshme për kryerjen e verifikimeve përkatëse.	F	Projektligji pasqyron kërkesën e proporcionalitetit, duke kufizuar kohëzgjatjen e kontroleve rrugore në kohën e arsyeshme të nevojshme për kryerjen e verifikimeve përkatëse.
5	Pa cenuar sanksionet e tjera që mund të vendosen, mjetet për të cilat konstatohet një ose më shumë shkelje e rregullave për transportin e mallrave të rrezikshme, veçanërisht shkelje të renditura në Aneksin II, mund të ndalohen në vend ose në një vend të caktuar për këtë qëllim nga autoritetet që kryejnë kontrollin dhe t'u kërkohej të sillen në përputhje përpara vijimit të udhëtimit, ose mund t'u nënshtrohen masave të tjera të përshtatshme, në varësi të rrethanave ose kërkesave të sigurisë, përfshirë, kur është e përshtatshme, refuzimin e lejimit të hyrjes së këtyre mjeteve në Bashkim.	1.1	52.1; 52.6–52.8	52.1 Kur gjatë kontrollit konstatohet një ose më shumë shkelje e rregullave për transportin rrugor të mallrave të rrezikshme, veçanërisht shkelje të përcaktuara në listën jo shteruese të miratuar në zbatim të nenit 49, pika 8, shkronja “b”, të këtij ligji, Policia Rrugore, pa cenuar sanksionet e tjera që mund të vendosen, merr masat e nevojshme në varësi të rrethanave, kategorisë së rrezikut të shkeljes dhe kërkesave të sigurisë.	F	Projektligji transpozon masat e zbatimit të kërkuara nga neni 5 i Direktivës, përfshirë ndalimin e mjetit, korrigjimin përpara vijimit të udhëtimit, masa të tjera të përshtatshme sigurie dhe, kur një mjet hyn nga një shtet tjetër, refuzimin e hyrjes deri në korrigjimin e shkeljes ose marrjen e masave të tjera të përshtatshme.

			52.6 Kur shkelja mund të cenojë sigurinë e transportit, Policia Rrugore mund: a) të ndalojë vijimin e transportit; b) të ndalojë mjetin në vend ose në një vend tjetër të caktuar për këtë qëllim nga autoriteti që kryen kontrollin; c) të kërkojë sjelljen e transportit në përputhje me kërkesat e këtij ligji dhe ADR-së përpara vijimit të udhëtimit; ç) të urdhërojë marrjen e masave për sigurimin, transferimin, shkarkimin, rregullimin, pastrimin ose dekontaminimin e ngarkesës, kur këto masa mund të kryhen pa rrezik; d) të kërkojë ndërhyrjen ose ndihmën e autoriteteve të tjera kompetente; dh) të njoftojë autoritetin që ka lëshuar autorizimin, certifikatën ose miratimin përkatës; e) të marrë masa të tjera të përshtatshme në varësi të rrethanave ose kërkesave të sigurisë. 52.7 Kur mjeti hyn në territorin e Republikës së Shqipërisë nga një shtet tjetër dhe shkelja e konstatuar cenon sigurinë e transportit, Policia Rrugore, në bashkëpunim me autoritetet doganore ose autoritetet kompetente kufitare, mund të refuzojë hyrjen e tij në territor deri në korrigjimin e shkeljes ose marrjen e masave të tjera të përshtatshme. 52.8 Transporti mund të vijojë vetëm pasi shkelja që cenon sigurinë të jetë korrigjuar ose pasi Policia Rrugore të ketë përcaktuar kushtet për vijimin e udhëtimit në mënyrë të sigurt.		
--	--	--	--	--	--

6.1, paragrafi i parë	Kontrollet mund të kryhen edhe në mjediset e ndërmarrjeve, si masë parandaluese ose kur gjatë kontrollit në rrugë janë konstatuar shkelje që cenojnë sigurinë e transportit të mallrave të rrezikshme.	1.1	53.1; 53.2	53.1 Kontrolli mund të kryhet edhe në mjediset e subjekteve të kontrollit, ku kryhen ose administrohen veprimtari të lidhura drejtpërdrejt me transportin rrugor të mallrave të rrezikshme, nga Policia Rrugore dhe, sipas objektit të kontrollit, nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial, autoritetet doganore ose autoritetet përgjegjëse sipas legjislacionit të posaçëm në fuqi. 53.2 Kontrolli sipas pikës 1 të këtij neni kryhet: a) si masë parandaluese; ose b) kur gjatë kontrollit rrugor janë konstatuar shkelje që cenojnë sigurinë e transportit të mallrave të rrezikshme.	F	Projektligji i shtrinë kontrollet përtej kontrolleve në rrugë, duke lejuar kontrolle në mjediset e subjekteve të kontrollit, si masë parandaluese ose pas shkeljeve të konstatuara në rrugë që cenojnë sigurinë e transportit të mallrave të rrezikshme.
6.1, paragrafi i dytë	Qëllimi i këtyre kontrolleve është të sigurohet që kushtet e sigurisë për transportin rrugor të mallrave të rrezikshme të jenë në përputhje me legjislacionin përkatës.	1.1	53.3	53.3 Qëllimi i kontrollit në mjediset e subjekteve të kontrollit është të sigurohet që kushtet e sigurisë për transportin rrugor të mallrave të rrezikshme të jenë në përputhje me këtë ligj dhe ADR-në.	F	Qëllimi i kontrolleve në mjediset e subjekteve përcaktohet shprehimisht në Projektligj: verifikimi që kushtet e sigurisë për transportin rrugor të mallrave të rrezikshme të jenë në përputhje me Projektligjin dhe ADR-në.
6.2	Kur në lidhje me transportin rrugor të mallrave të rrezikshme konstatohet një ose më shumë shkelje, veçanërisht ato të renditura në Aneksin II, transporti përkatës duhet të vihet në përputhje përpara se mallrat të largohen nga ndërmarrja ose t'u nënshtrohet masave të tjera të përshtatshme.	1.1	53.4	53.4 Kur në mjediset e subjektit të kontrollit konstatohet një ose më shumë shkelje që lidhen me transportin rrugor të mallrave të rrezikshme, veçanërisht shkelje të përcaktuara në listën jo shteruese të miratuar në zbatim të nenit 49, pika 8, shkronja "b", të këtij ligji, transporti përkatës vihet në përputhje përpara se mallrat të largohen nga këto mjedise ose i nënshtrohet masave të tjera të përshtatshme.	F	Projektligji transpozon kërkesën që, kur shkeljet konstatohen në mjediset e subjektit të kontrollit, transporti përkatës të vihet në përputhje përpara se mallrat të largohen nga mjediset ose t'u nënshtrohet masave të tjera të përshtatshme.
7.1	Shtetet anëtare ndihmojnë njëri-tjetrin për t'i dhënë kësaj direktive zbatim të duhur.	1.1	54.1	54.1 Republika e Shqipërisë, nëpërmjet strukturës përgjegjëse për transportin e mallrave të rrezikshme dhe autoriteteve të tjera kompetente,	F	Projektligji krijon një mekanizëm të përgjithshëm bashkëpunimi dhe shkëmbimi informacioni me

				bashkëpunon dhe shkëmben informacion me autoritetet kompetente të shteteve të tjera për zbatimin e këtij kreu dhe për sigurimin e zbatimit efektiv të rregullave për kontrollin rrugor të transportit të mallrave të rrezikshme.		autoritetet kompetente të shteteve të tjera, nëpërmjet strukturës përgjegjëse për transportin e mallrave të rrezikshme dhe autoriteteve të tjera kompetente.
7.2, paragrafi i parë	Shkeljet serioze ose të përsëritura që cenojnë sigurinë e transportit të mallrave të rrezikshme, të kryera nga një mjet ose ndërmarrje jorezidente, u raportohen autoriteteve kompetente të shtetit anëtar ku është regjistruar mjeti ose ku është themeluar ndërmarrja.	1.1	54.2; 54.3	54.2 Kur konstatohen shkelje serioze ose të përsëritura që cenojnë sigurinë e transportit të mallrave të rrezikshme dhe që janë kryer nga një mjet i regjistruar në një shtet tjetër ose nga një subjekt që ka selinë në një shtet tjetër, autoriteti që ka konstatuar shkeljen i përcjell informacionin strukturës përgjegjëse për transportin e mallrave të rrezikshme. 54.3 Struktura përgjegjëse për transportin e mallrave të rrezikshme, sipas rastit, njofton autoritetet kompetente të shtetit ku është regjistruar mjeti ose ku subjekti ka selinë, në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare, marrëveshjet dypalëshe ose shumëpalëshe.	F	Projektligji parashikon raportimin e shkeljeve serioze ose të përsëritura që cenojnë sigurinë e transportit, kur ato përfshijnë një mjet të regjistruar në një shtet tjetër ose një ndërmarrje të themeluar në një shtet tjetër.
7.2, paragrafi i dytë	Autoritetet kompetente të shtetit anëtar ku janë konstatuar shkelje serioze ose të përsëritura mund t'u kërkojnë autoriteteve kompetente të shtetit anëtar ku është regjistruar mjeti ose ku është themeluar ndërmarrja të marrin masa të përshtatshme ndaj shkelësit ose shkelësve.	1.1	54.4	54.4 Kur shkelje serioze ose të përsëritura janë konstatuar në territorin e Republikës së Shqipërisë, struktura përgjegjëse për transportin e mallrave të rrezikshme mund të kërkojë nga autoritetet kompetente të shtetit ku është regjistruar mjeti ose ku subjekti ka selinë marrjen e masave të përshtatshme ndaj shkelësit ose shkelësve.	F	Projektligji i mundëson strukturës kompetente shqiptare t'u kërkojë autoriteteve kompetente të shtetit ku është regjistruar mjeti ose ku është themeluar ndërmarrja marrjen e masave të përshtatshme.
7.2, paragrafi i tretë	Autoritetet kompetente të shtetit anëtar ku është regjistruar mjeti ose ku është themeluar ndërmarrja njoftojnë autoritetet kompetente të shtetit anëtar ku janë konstatuar shkeljet për çdo masë të marrë ndaj transportuesit ose ndërmarrjes përkatëse.	1.1	54.5	54.5 Kur autoritetet kompetente shqiptare marrin njoftim nga një shtet tjetër për shkelje serioze ose të përsëritura të kryera nga mjet i regjistruar në Republikën e Shqipërisë ose nga subjekt që ka selinë në Republikën e Shqipërisë, ato shqyrtojnë rastin, marrin masat përkatëse sipas kompetencës	F	Projektligji mbulon edhe situatën reciproke, duke u kërkuar autoriteteve kompetente shqiptare të shqyrtojnë njoftimet e marra nga një shtet tjetër, të marrin masat e përshtatshme brenda kompetencës

				dhe njoftojnë autoritetin që ka përcjellë informacionin për masat e marra.		së tyre dhe të informojnë autoritetin njoftues për masat e marra.
Neni 8, paragrafi i parë	Kur gjetjet e një kontrolli në rrugë ndaj një mjeti të regjistruar në një shtet tjetër anëtar japin arsye për të besuar se janë kryer shkelje serioze ose të përsëritura, të cilat nuk mund të zbulohen gjatë atij kontrolli për shkak të mungesës së të dhënave të nevojshme, autoritetet kompetente të shteteve anëtare përkatëse ndihmojnë njëri-tjetrin për sqarimin e situatës.	1.1	54.6	54.6 Kur rezultatet e kontrollit rrugor ndaj një mjeti të regjistruar në një shtet tjetër japin arsye për të besuar se janë kryer shkelje serioze ose të përsëritura, të cilat nuk mund të verifikohen gjatë këtij kontrolli për shkak të mungesës së të dhënave të nevojshme, autoritetet kompetente, nëpërmjet strukturës përgjegjëse për transportin e mallrave të rrezikshme, bashkëpunojnë me autoritetet kompetente të shtetit përkatës për sqarimin e rastit.	F	Projektligji transpozon mekanizmin e bashkëpunimit për rastet kur kontrolli në rrugë jep arsye për të dyshuar për shkelje serioze ose të përsëritura që nuk mund të verifikohen plotësisht gjatë kontrollit për shkak të mungesës së të dhënave.
Neni 8, paragrafi i dytë	Kur, për këtë qëllim, shteti anëtar kompetent kryen kontroll në ndërmarrje, shtetet e tjera anëtare përkatëse njoftohen për rezultatet.	1.1	54.7	54.7 Kur, për sqarimin e rastit sipas pikës 6 të këtij neni, kryhet kontroll në mjediset e subjektit të kontrollit në Republikën e Shqipërisë, struktura përgjegjëse për transportin e mallrave të rrezikshme njofton autoritetet kompetente të shteteve të tjera të interesuara për rezultatet e kontrollit.	F	Projektligji parashikon që, kur për sqarimin e një rasti të tillë kryhet kontroll në mjediset e një subjekti të kontrollit, autoritetet kompetente të shteteve të interesuara njoftohen për rezultatet.
9.1, paragrafi i parë	Çdo shtet anëtar i dërgon Komisionit, për çdo vit kalendarik, jo më vonë se 12 muaj pas përfundimit të atij viti, një raport, të hartuar në përputhje me formularin model standard të përcaktuar në Aneksin III të kësaj direktive, për zbatimin e Direktivës 95/50/KE dhe të kësaj direktive, duke përfshirë të dhënat e mëposhtme:	N/A	N/A	N/A	N/A	Detyrimi vjetor i raportimit sipas nenit 9(1) është historik për shtetet anëtare dhe nuk zbatohet për Shqipërinë përpara anëtarësimit në BE. Raportimi pas anëtarësimit të Shqipërisë trajtohet në nenin 9(1a) dhe në nenin 56, pika 6, të Projektligjit.
9.1.a	a) kur është e mundur, vëllimin e përcaktuar ose të vlerësuar të mallrave të rrezikshme të transportuara me rrugë, në ton të transportuar ose në ton/kilometra;	N/A	N/A	N/A	N/A	Si më sipër.
9.1.b	b) numrin e kontrolleve të kryera;	N/A	N/A	N/A	N/A	Si më sipër.

9.1.c	c) numrin e mjeteve të kontrolluara sipas vendit të regjistrimit (mjetë të regjistruara në vend, në shtete të tjera anëtare ose në vende të treta);	N/A	N/A	N/A	N/A	Si më sipër.
9.1.d	d) numrin e shkeljeve të regjistruara sipas kategorisë së rrezikut, siç referohet në Aneksin II;	N/A	N/A	N/A	N/A	Si më sipër.
9.1.e	e) llojin dhe numrin e sanksioneve të vendosura.	N/A	N/A	N/A	N/A	Si më sipër.
9.1, paragrafi i dytë	Raporti i fundit sipas paragrafit të parë i paraqitet Komisionit deri më 31 dhjetor 2024 dhe mbulon periudhën nga 1 janari 2023 deri më 31 dhjetor 2023.	N/A	N/A	N/A	N/A	Nuk kërkohet transpozim.
